

MENDIMI I PAKICËS I
VENDIMIT NR.30, DATË 23.10.2003 I GJYKATËS KUSHTETUESE
(BOTUAR NË FLETOREN ZYRTARE NR.89)

Nuk jemi dakord me konkluzionet e shumicës. Mendojmë se vendimi nr.348, datë 18.2.2003 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është rezultat i një procesi të parregullt ligjor në kuptimin kushtetues dhe si i tillë duhej të shfuqizohej nga Gjykata Kushtetuese.

Pretendimi kryesor pranë Gjykatës Kushtetuese i kërkueses, ka qenë mosrespektimi nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i të drejtës së saj për t'u mbrojtur me avokat, duke u vendosur kështu në kushte të pabarabarta gjykimi. Ne mendojmë se nga materialet e dosjes ky pretendim provohet plotësisht.

Përmes jurisprondencës së pasur të saj, Gjykata Kushtetuese ka pranuar se e drejta e mbrojtjes dhe barazia e armëve në kuptimin kushtetues janë elemente thelbësore të procesit të rregullt ligjor. Mbi këtë bazë është theksuar se gjykatave të të gjitha niveleve u dalin një sërë detyrash, në mënyrë që brenda kuadrit ligjor ekzistues dhe mundësive të garantojnë sa më mirë parimin e barazisë së armëve dhe të mbrojtjes efektive të palëve në gjykim. Nga ana tjetër, Gjykata Kushtetuese ka evidentuar domosdoshmërinë dhe rëndësinë e veçantë të mbrojtjes me avokat në gjykimet që zhvillohen në Gjykatën e Lartë. Çështjet që trajtohen aty kanë natyrë të mirëfilltë ligjore, prandaj të drejtat dhe liritë e shtetasve pranë kësaj gjykate mund të mbrohen me efektivitet dhe profesionalizëm vetëm përmes avokatit që përfaqëson palët.

Rezulton e provuar se ditën e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, kërkuësja është paraqitur vetë dhe i ka kërkuar që në fillim të seancës, Kolegjit Civil të kësaj gjykate, shtyrjen e gjykimit të çështjes me arsyetimin se avokati i caktuar prej saj ishte i sëmurë, gjë që vërtetohet edhe nga raporti mjekësor që përmban dosja. Pra, përderisa nuk mund të provohet e kundërta, duhet pranuar se ajo i kishte marrë masat për t'u përfaqësuar me avokat ditën e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, por sigurisht, nuk mund të parashikonte që pikërisht këtë ditë, avokati i saj do të ishte i sëmurë.

Në vendim nuk përmenden një sërë faktesh të tjera që ka dosja dhe që u parashtruan në seancën gjyqësore që u zhvillua në Gjykatën Kushtetuese, të cilat, pavarësisht nga besueshmëria që paraqesin, përderisa nuk mund të rrëzohen, duhej të llogariteshin në favor të kërkesës. Kështu, u paraqit një prokurë përmes së cilës vërtetohet se rreth një javë para gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, kërkuësja ka caktuar si përfaqësues të saj ligjor pikërisht avokatin e deklaruar si mbrojtës të saj në seancën e zhvilluar pranë kësaj gjykate. Mosparaqitja e kësaj prokure, së bashku me rekursin, u justifikua me praktikën që zbatojnë normalisht gjykatat e të gjitha niveleve, që do të thotë se ajo paraqitet dhe verifikohet ditën e zhvillimit të seancës gjyqësore. Për më tepër, avokati i kërkueses theksoi në seancën e zhvilluar në Gjykatën Kushtetuese se rekursi i paraqitur në Gjykatën e Lartë ishte hartuar nga vetë ai, pavarësisht se përmbante vetëm nënshkrimin e klientes së tij.

Duke qenë kështu, mendojmë se konkluzioni i shumicës se Gjykata e Lartë i ka përmbushur detyrimet e veta me shpalljen e listës dhe të datës së gjykimit të çështjes dhe kërkuësja duhej të merrte vetë masat në kohën e duhur për të caktuar avokatin që të përgatiste një mbrojtje efektive, nuk është i bazuar.

Për sa më sipër, mendojmë se në procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, kërkueses i është mohuar dukshëm e drejta e mbrojtjes. Në këtë gjykim ajo është vënë në pozitë krejt të pabarabartë me palën tjetër.

Anëtarë: K. Peçi, A. Karamuço, Xh. Zaganjori. Kryetar: F. Abdiu